



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.3**

**15 janar**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Udhëzim i MB nr.98, datë 15.1.2007	Për procedurat e hartimit të listave paraprake të zgjedhësve “Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 18 shkurt 2007” ..... 59
Vendim i GJK nr.1, datë 12.1.2007	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.268, datë 6.10.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.520, datë 6.7.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën..... 60

**UDHËZIM**  
**Nr. 98, datë 15.1.2007**

**PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË LISTAVE PARAPRAKE TË ZGJEDHËSVE**  
**“PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE**  
**TË DATËS 18 SHKURT 2007”**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të dekretit të Presidentit të Republikës nr.5194, datë 14.1.2007 “Për caktimin e datës 18 shkurt 2007 për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore”, të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.9297, datë 21.10.2004, ligjin nr.9341, datë 10.1.2005, ligjin nr.9371, datë 14.4.2005 dhe ligjin nr.9676, datë 13.1.2007,

**UDHËZOJ:**

1. Sipas listës së marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, të përdorur për zgjedhjet e vitit 2005 brenda datës 21 janar 2007, zyrat e gjendjes civile, nën autoritetin e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, mbështetur në regjistrat themeltarë me vendbanim të gjendjes civile, kryejnë përditësimin e listës si më poshtë:

a) evidentojnë dhe regjistrojnë të gjithë shtetasit që kanë mbushur moshën 18 vjeç pas datës së zgjedhjeve të fundit, duke përfshirë edhe ata që mbushin moshën 18 vjeç deri në datën 18 shkurt 2007;

b) evidentojnë dhe regjistrojnë në listën zgjedhore të njësisë së qeverisjes vendore zgjedhësit që janë regjistruar, shtuar në regjistrat themeltarë me vendbanim të gjendjes civile të kësaj njësie pas zgjedhjeve të fundit;

c) evidentojnë dhe çregjistrojnë zgjedhësit, që nuk figurojnë më në regjistrin themeltar me vendbanim të zyrave të gjendjes civile, për arsye se kanë vdekur ose kanë lënë shtetësinë shqiptare pas zgjedhjeve të fundit;

ç) evidentojnë dhe çregjistrojnë nga lista zgjedhore e njësisë së qeverisjes vendore, zgjedhësit të cilët janë në listë, por nuk ndodhen në regjistrin themeltar me vendbanim të kësaj njësie;

d) korrigjojnë problemet e evidentuara në listat e mëparshme, duke u bazuar në informacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe duke bërë kontrollin e tyre në regjistrat themeltarë me vendbanim.

2. Jo më vonë se data 21 janar 2007, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën ndarjen e zgjedhësve sipas zonave të qendrave të votimit të zgjedhjeve të fundit dhe u cakton atyre numrin e qendrës përkatëse të votimit. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore cakton vendndodhjen e saktë, adresën e plotë të qendrave të votimit, përgatit hartën e njësisë së qeverisjes vendore, në të cilën janë vendosur edhe kufijtë e zonave të qendrave të votimit dhe e shpall atë në mjedise publike, me hyrje të lirë, brenda njësisë së qeverisjes vendore. Kryetari i njësisë përkatëse mban të pandryshuar vendndodhjen dhe adresën ekzistuese të qendrës së votimit dhe, kur kjo është e pamundur, ndryshimi bëhet me miratim të KQZ-së. Ai nuk mund të ndryshojë vendndodhjen e qendrës së votimit në 25 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveçse në rastet e forcave madhore.

3. Listat paraprake shpallen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore jo më vonë se data 21 janar 2007, pranë zyrave të njësisë përkatëse dhe çdo qendër votimi, duke i vendosur në mjedise publike me hyrje të lirë për shtetasit. Një kopje e këtyre listave u dërgohet zyrave të gjendjes civile përkatëse, të cilat përditësojnë në regjistrat themeltarë me vendbanim të gjendjes civile numrin e zonës së qendrës së votimit për çdo zgjedhës. Një kopje tjetër e këtyre listave i dërgohet menjëherë në format elektronik Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

4. Për përgatitjen e listave të zgjedhësve, NJQV-të përdorin vetëm programin kompjuterik të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BRENDSHËM  
Sokol Olldashi

**VENDIM**  
**Nr. 1, datë 12.1.2007**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 13.9.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.32/3 Akti që i përket:

**KËRKUES:** VEZIRE SINA (SHARKA), përfaqësuar nga avokat Agim Gogu, me prokurë.

**SUBJEKT I INTERESUAR:** PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurori Artur Selmani, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.268, datë 6.10.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.520, datë 6.7.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42,131/f e 134/g të Kushtetutës.

*Kërkuesja* ka parashtruar përpara Gjykatës Kushtetuese këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve të sipërcituara:

- Nuk i është krijuar mundësia për një mbrojtje efektive. Avokati që e ka asistuar gjatë fazës së hetimeve ka qenë i caktuar kryesisht nga organi i prokurorisë dhe nuk i është bërë i njohur kur jam marrë në pyetje;

- Gjatë veprimeve të para procedurale është detyruar të dëshmojë kundër vetes e të pohojë fajësinë.

- Është deklaruar fajtorë dhe është dënuar nga gjykatat mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

- Gjykata nuk ka marrë në konsideratë kërkesën për administrimin në seancë gjyqësore të materialeve të veçuara nga dosja hetimore, në të cilën ndodhen të dhëna që e shfajësojnë.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Vjollca Meçaj, përfaqësuesin e kërkueses që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar që u shpreh për rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr.52, datë 24.5.2004, ka deklaruar të pafajshme kërkuesen Vezire Sina për akuzën e vrasjes me paramendim dhe armëmbajtje pa leje. Gjykata e Apelit Vlorë, mbi ankimin e prokurorit, me vendimin nr.268, datë 6.10.2004, ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe përfundimisht e ka deklaruar fajtorë atë, duke e dënuar në bazë të neneve 78/1, 278/2 dhe 55/2 të Kodit Penal me 17 vjet burg. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.520, datë 6.7.2005, ka lënë në fuqi këtë vendim.

Lidhur me shkakun e parë, kërkuësja pretendon se prania gjatë procesit hetimor e një mbrojtësi, pa iu bërë i njohur asaj, si e pandehur, i ka cenuar efektivitetin e mbrojtjes, e për pasojë dhe vetë të drejtën e mbrojtjes të parashikuar nga neni 31/ç i Kushtetutës dhe neni 6/3/c i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ndryshe nga sa pretendohet, Gjykata Kushtetuese konstaton se në të gjitha veprimet procedurale të kryera lidhur me hetimin dhe gjykimin e veprës penale në ngarkim të kërkueses, ka qenë gjithmonë i pranishëm një avokat, i pakontestuar prej saj. Rezulton se i njëjti avokat ka qenë i pranishëm gjatë pyetjes së kërkueses si person ndaj të cilit zhvillohen hetime, gjatë komunikimit të akuzës, gjatë përpilimit të procesverbalit hetimor për verifikimin e thënieve të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, si dhe në seancën gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit. Rezulton gjithashtu se, në të paktën dy raste, këtë avokat kërkuësja e ka deklaruar në mënyrë të shprehur, si të zgjedhur prej saj. Kjo ka ndodhur në seancën gjyqësore të caktimit të masës së sigurimit, si dhe në procesverbalin e pyetjes së kërkueses si person ndaj të cilit zhvillohen hetime, ku është pasqyruar se vetë kërkuësja, pasi është pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore, ka nominuar si mbrojtës avokatin në fjalë.

Kërkuësja pretendoi gjithashtu se është deklaruar fajtorë mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Gjykata Kushtetuese këtë pretendim e konsideron të lidhur me parimet që u referohen provave. Sipas këtyre parimeve, vlerësimi i provave, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të Gjykatës Kushtetuese, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor. Gjykata vlerëson se jo çdo lloj shkeljeje në këtë drejtim e bën tërësisht procesin gjyqësor të parregullt, pasi procesi duhet të vlerësohet në tërësinë e ecurisë së tij. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese konstaton se gjatë gjykimit janë administruar edhe prova të tjera, të cilat janë vlerësuar nga gjykatat përkatëse si të mjaftueshme për të provuar fajësinë e kërkueses. Asaj i është dhënë mundësia të bëjë komentet përkatëse lidhur me provat, në momentin kur janë administruar si të tilla nga gjykatat e faktit. Për pasojë, gjykatat e kanë bërë vlerësimin e tyre lidhur me akuzën duke pasur parasysh edhe prapsimet e kërkueses në lidhje me provat që pretendohet se janë marrë në mënyrë të paligjshme.

Për paligjshmërinë e marrjes së provave, kërkuësja pretendon se në veprimet e para procedurale është detyruar të vetëfajësohet në lidhje me akuzën. Ky pretendim nuk u vërtetua. Ai nuk u mbështet me asnjë provë gjatë gjykimit kushtetues të çështjes. Në të kundërt, nga dokumentet e dosjeve hetimore e gjyqësore rezulton se ajo e ka përsëritur pohimin e saj për fajësinë disa herë, në kohë e veprime të ndryshme procedurale, si dhe përpara gjykatës që ka caktuar masën e sigurimit për të si e pandehur.

I pabazuar rezultoi edhe pretendimi tjetër i kërkueses, lidhur me refuzimin e gjykatave të faktit për të marrë dhe administruar provat që e shfajësojnë kërkuesen.

Nga materialet e dosjes rezultoi se avokati i kërkuases ka kërkuar bashkimin e akteve të veçuara nga dosja hetimore vetëm përpara Gjykatës së Lartë, ndërkohë që një kërkesë të tillë nuk e ka paraqitur përpara gjykatës së rrethit gjyqësor dhe asaj të apelit. Në të kundërt rezultoi se provat e kërkuara shprehimisht nga përfaqësuesi i kërkuases në gjykim janë marrë e administruar rregullisht nga gjykatat.

Në kushtet sa më sipër, Gjykata Kushtetuese konstaton se pretendimet e kërkuases nuk qëndrojnë, prandaj kërkesa duhet rrëzuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468**  
**Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.**

### **BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
  - 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) ..... 1500**
  - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) ..... 600**
  - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
  - 4. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**

### **BOTIME TË REJA**

- 1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 2. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 3. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 4. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 5. PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
- 6. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
- 7. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
- 8. PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
- 9. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

Hyri në shtyp më 15.1.2007  
Doli nga shtypi më 15.1.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Grafon  
Tiranë, 2007

Çmimi: 8 lekë